

L I G J
Nr.8494, datë 27.5.1999

PËR MIRATIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË, SHOQATËS “KOMUNITETI EMANUEL” DHE CARITAS-IT SHQIPTAR PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SOCIALE POLIVALENTE NË VAQARR, TIRANË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, Shoqatës “Komuniteti Emanuel” dhe CARITAS-it Shqiptar për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Sociale Polivalente në Vaqarr, Tiranë” të nënshkruar më 26.1.1999.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2392, datë 7.6.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SHQIPTARE, SHOQATËS “KOMUNITETI EMMANUEL” DHE CARITAS-IT SHQIPTAR PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS SOCIALE POLIVALENTE NË VAQARR, TIRANË

Qeveria Shqiptare, Shoqata “Komuniteti Emmanuel” dhe Caritas-i Shqiptar

Duke pasur parasysh faktin se si rezultat i kushteve të tranzicionit në të cilën ndodhet Shqipëria janë evidentuar një sërë problemesh sociale (varfëria, droga, alkooli etj.) të cilat kërkojnë një ndërhyrje për zbutjen e parandalimin e tyre.

Duke pasur parasysh faktin se ekziston një numër i konsiderueshëm fëmijësh dhe grash në nevojë si dhe të rinj përdorues të drogës e alkoolit, sidomos në zonat urbane të cilët kanë nevojë për ndihmën e shtetit dhe shoqërisë.

Duke pasur parasysh faktin se qëllimi i kësaj marrëveshjeje është që t’iu ofrojë trajtim psiko-pedagogjik dhe teraupetik nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të qendrës polivalente dhe rehabilitimin dhe integrimin social të kategorive shoqërore të përmendura më sipër.

Duke pasur parasysh përvojën që ka Shoqata “Komuniteti Emmanuel” në ngritjen dhe funksionimin e qendrave të tilla dhe trajtimin në to të kategorive nevojtare të shoqërisë.

Duke pasur parasysh faktin se në Republikën e Shqipërisë nuk ekziston asnjë qendër e tillë polivalente shtetërore apo private për trajtimin njëkohësisht të problemeve të fëmijëve dhe

grave në nevojë, si dhe të adoleshentëve dhe të rinjve që janë përdorues të drogës e alkoolit.

Duke patur parasysh faktin që Qeveria Shqiptare është dakord për ngritjen e Qendrës Sociale Polivalente “Emmanuel” në Republikën e Shqipërisë (Vaqarr të rrethit të Tiranës).

Palët nënshkruese janë dakord të lidhin një marrëveshje si më poshtë:

I. Objekti i marrëveshjes.

1.1 Bashkëpunim në fushën e përkujdesjes shoqërore, i cili konsiston në ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Sociale Polivalente “Emmanuel” (që më poshtë do të quhet “Qendër”) për t’iu përgjigjur disa problemeve emergjente të kohës për kategoritë e mëposhtme:

- gratë në vështirësi dhe me fëmijë
- fëmijë, adoleshentë dhe të rinj të braktisur ose në rrezik
- përdorues të drogës dhe alkoolit, të braktisur etj.

2. Kohëzgjatja e marrëveshjes

2.1 Marrëveshja do të vazhdojë për një periudhë 25 vjet. Palët nënshkruese janë të detyruara të rishikojnë marrëveshjen në varësi të ndryshimeve të legjislacionit shqiptar gjatë kësaj periudhe.

2.2 Palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje ruajnë të drejtën e shtyrjes së afatit të marrëveshjes duke bërë ndryshimet e nevojshme në varësi të ndryshimeve dhe nevojave, kushteve dhe ndryshimeve të legjislacionit shqiptar.

3. Qëllimi i marrëveshjes.

3.1 Qëllimet e veprimtarisë së Caritas-it Shqiptar dhe Shoqatës “Komuniteti Emmanuel” në këtë marrëveshje janë humanitare dhe jofitimprurëse.

3.2 Qëllimet e kësaj marrëveshjeje janë bazuar në shqetësimin dhe kujdesin nëpërmjet trajtimit në përputhje të një programi të përcaktuar për rehabilitimin dhe integrimin social të gruas, fëmijëve e adoleshentëve në nevojë, si dhe përdoruesit e drogës e të alkoolit duke respektuar liritë ideologjike dhe të besimit fetar, në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe dokumentet e të drejtave të njeriut.

4. Financimi

4.1 Projekti mbi bazën e të cilit lidhet kjo marrëveshje financohet tërësisht nga Shoqata “Komuniteti Emmanuel” dhe ka një vlerë prej 1580 000 000 lireta italiane.

5. Palët nënshkruese në marrëveshje

5.1 Ministria e Punës përfaqësuar nga Ministri zoti Kadri Rrapi.

5.2 Shoqata “Komuniteti Emmanuel” (e cila më poshtë do të quhet “Komuniteti” shoqatë joqeveritare humanitare e pa qëllim fitimi, me seli në Lecce të Italisë dhe adresë: Rr.Don Bosco, 16 73 100, regjistruar si person juridik me vendim të Gjykatës së rrethit të Tiranës me nr.1924, datë 18.5.1998, përfaqësuar nga z.Beniamin Ceta.

5.3 Caritas-i shqiptar, shoqatë joqeveritare, fetare e bamirëse pa qëllim përfitimi ekonomik, me adresë: Rr.Don Bosko - Tiranë, regjistruar si person juridik me vendim të formës së prerë të Gjykatës së rrethit Tiranë me nr.6415, datë 16.10.1995, përfaqësuar nga Don Nik Pace.

6. Shoqata “Komuniteti Emmanuel” merr përsipër

6.1 Të vërë në jetë programin sipas linjave operative të përligjura në dokumentin e projektit bashkëngjitur.

6.2 Të gjejë një vend ndërtimi të përshtatshëm për ngritjen e Qendrës dhe të blejë tokën me shpenzimet e saj.

6.3 Të zbatojë të gjithë legjislacionin e Republikës së Shqipërisë që është në fuqi.

6.4 Brenda territorit të tokës së blerë të zhvillojë në strukturën e tij ndërtesa dhe terrene (sipas projektit) dhe veprimtari pune me vetfinancim (nisma bujqësore-artizanale) të cilat nuk do të kenë qëllim fitimi.

6.5 Të garantojë deri në realizimin e projektit mbulimin me shpenzimet e veta të ngritjes e funksionimit të qendrës, pagat e personelit duke përfshirë në to sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

6.6 Në 3-6 muajt e parë të merret me formimin e operatorëve në mënyrë që ata të mund të

jenë të gjithë ose pjesërisht shqiptarë dhe në të njëjtën kohë t'i hapet rruga e pritjeve të para. Pasi të arrihet gradualisht në 10 numri i pjesëtarëve, do të vlerësohet programi psiko-pedagogjik dhe terapeutik i ndërhyrjes, rezultatet e para, problemet dhe mundësitë, duke kërkuar që të zgjerohet gradualisht shërbimi.

6.7 Të bëjë seleksionimin e kandidatëve për në Qendër duke u bazuar në vlerësimin e kushteve dhe motiveve dhe në veçanti të pranimi të programit nga ana e kandidatit.

6.8 Të bëjë seleksionimin e operatorëve shqiptarë për pjesëmarrje në projekt duke u mbështetur në vlerësimin e qëndrimeve njerëzore e profesionale dhe pjesëmarrjen e kërkuar në bazë të principeve që frymëzojnë Komunitetin (si gatishmëria për shërbim dhe vullnetarizmi).

6.9 Të sigurojë në Qendër shërbime, të cilat të jenë të paktën të të njëjtit nivel me ato të siguruara në institucionet shtetërore të përkujdesjes shoqërore.

6.10 Të sigurojë në Qendër ushqime të garantuara dhe normativat e shpërndarjes të jenë sipas kriterëve të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

6.11 Të sigurojë në Qendër kushte higjieno-sanitare dhe mjekësore në përputhje me kriteret e vendosura nga Ministria e Shëndetësisë.

6.12 Të ruajë deri në përfundim të afatit të marrëveshjes destinacionin e Qendrës Polivalente dhe të mjediseve në shërbim të saj.

6.13 Të aktivizojë çdo formë financimi të mundshëm në nivel kombëtar, ndërkombëtar, si dhe të vetfinancimit si kusht financiar për realizimin e projektit.

6.14 T'i japë një relacion periodik (çdo 6 muaj) institucionit që përfaqëson Qeverinë Shqiptare mbi ecurinë e zbatimit të projektit.

7. Caritas-i Shqiptar merr përsipër:

7.1 T'i besojë KOMUNITETIT të gjitha përgjegjësitë lidhur me zhvillimin e aspekteve strukturore, teknike, terapeutike dhe të drejtimit të projektit bashkëngjitur dhe të jetë garant për realizimin e tij.

7.2 Të respektojë të gjithë legjislacionin shqiptar në fuqi.

8. Qeveria e Republikës së Shqipërisë merr përsipër:

8.1 Të miratojë projektin "Qendër Sociale Polivalente", të pranojë metodologjinë e ndërhyrjes psiko-pedagogjike dhe terapeutike që Komuniteti do të aplikojë, në bazë të asaj që është specifikuar në projekt.

8.2 Të lehtësojë nxjerrjen e licensave, lejet e zakonshme dhe autorizimeve për vënien në jetë dhe përfundimin sa më mirë të projektit.

8.3 Të përjashtojë të gjitha veprimtaritë e Komunitetit dhe Caritas-it të cilat janë të lidhura me projektin dhe programin e Qendrës Polivalente nga të gjitha taksat si ato doganore ashtu dhe ato administrative, duke përfshirë edhe TVSH-në.

8.4 Të sigurojë ndërhyrje mjekësore të specializuara, analiza laboratorike, shtrime në spital dhe çfarëdo tjetër që do të jetë e domosdoshme për zbatimin e programit të Qendrës gjithnjë në planin shëndetësor dhe të marrë përsipër shpenzimet financiare për to.

8.5 Të garantojë sigurimin e Qendrës Polivalente.

8.6 Të sigurojë furnizimin me ujë, energji elektrike, gazin (në masën që bëhet furnizimi i popullatës së vendit), kanalizimet, rrugët lidhëse për transport, linjën telefonike, si dhe shërbime të tjera që mund të nevojiten për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës.

8.7 Të sigurojë asistencë ligjore për klientët e Qendrës në qoftë se kjo do të jetë e nevojshme.

8.8 Të angazhohet për veprimtaritë e reintegrimit social dhe në punë të kandidatëve të Qendrës, aspekte të rëndësishme për vetë projektin.

8.9 Të emërojë një person nga Administrata e Përgjithshme e Ndihmës dhe e Shërbimeve Sociale të cilit do t'i referohen për të gjitha kompetencat e parashikuara në këtë kontratë.

8.10 Qeveria shqiptare rezervon të drejtën e kundërshtimit, në raste kur do të konsiderojë diçka si të papajtueshme me/ose të dëmshme për normat, rregullat dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë.

9. Mbarimi i marrëveshjes

9.1 Kjo marrëveshje përfundon:

-Me mbarimin e afatit të përcaktuar në marrëveshje.

-Kur shkelen detyrimet e palëve dhe dispozitat e kësaj marrëveshje.

- Kur nga palët konstatohet largim nga objekti dhe qëllimi i marrëveshjes.

9.2 Në rastin e zgjidhjes në mënyrë të njëanshme të marrëveshjes palët do të përgjigjen për pasojat që lindin nga moszbatimi i kushteve të marrëveshjes në varësi të detyrimit që ato kanë marrë përsipër në këtë marrëveshje.

9.3 Në përfundim të marrëveshjes nëse ajo nuk do të rinovohet, godina me të gjitha pajisjet i mbetet palës shqiptare, pra Caritas-it Shqiptar.

10. Pikat e diskutimit.

10.1 Kur palët kanë mosmarrëveshje midis tyre, krijohet një komision i përbashkët trepalësh me përfaqësues nga Qeveria Shqiptare, Komuniteti dhe Caritas-i të cilët brenda 2 muajve do të zgjidhin mosmarrëveshjet nëpërmjet bisedimeve dhe frymës së mirëkuptimit dhe nëse palët nuk bien dakord, çështja do të zgjidhet me rrugë gjyqësore.

11. Dokumentet shoqëruese të marrëveshjes janë:

-Statuti i shoqatës “Caritas”.

-Statuti i shoqatës “Komuniteti Emmanuel”.

-Vendimi i regjistrimit në gjykatë të shoqatës “Caritas”.

- Vendimi i regjistrimit në gjykatë të shoqatës “Komuniteti Emmanuel”.

-Akti i themelimit të shoqatës “Caritas”.

-Akti i themelimit të shoqatës “Komuniteti Emmanuel”.

-Historiku i veprimtarisë së shoqatës “Caritas”.

-Historiku i veprimtarisë së shoqatës “Komuniteti Emmanuel”.

-Projekti për Qendrën Sociale Polivalente Emmanuel

-Kërkesa zyrtare për ushtrim veprimtarie

-Dokumenti për vërtetësinë e pronësisë mbi tokën

-Garancia bankare e “Komunitetit Emmanuel”

12. Data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes

12.1 Marrëveshjen pasi e lexuan palët e gjetën atë konform ligjit dhe me vullnetin e tyre të plotë e nënshkruan sot më datë 26.1.1999, Tiranë.

12.2 Marrëveshja është hartuar në gjuhën shqipe në pesë kopje origjinale.

12.3 Kjo marrëveshje nënshkruhet nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të Shqipërisë, Komuniteti Emmanuel dhe Caritas-i Shqiptar dhe hyn në fuqi pas miratimit në Kuvend.